



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Shtator 2022

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Shtator 2022

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin shtator të vitit 2022)**

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive diskutoi për mbajtjen e takimit me të gjithë administratorët e prokurorive për të diskutuar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me administrimin e prokurorive, me fokus të veçantë në zbatimin e SMIL-it dhe përputhshmërinë e regjistrave të lëndëve.



Komisioni u njoftua edhe për vizitën e Grupit monitorues për zbatimin e SMIL-it në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, si dhe për të gjeturat gjatë këtij monitorimi.

KPK refuzon Marrëveshjen Vullnetare të Panelit Hetimor në rastin AD.nr.05\2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) mbajti takimin e 219-të, në të cilin anëtarët e KPK-së aprovuan vendimin për pagesën e ekspertëve, përfshirë edhe mjekoligjorët që ofrojnë shërbime profesionale për sistemin prokurorial, pagesë kjo, e cila do të realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.



KPK-ja ka shtyrë për në takimin e ardhshëm prezantimin e raporteve të punës së kryeprokurorëve të prokurorive për periudhën prill-qershor 2022 dhe ka marrë vendim për t'ia dërguar kërkesën Presidentes së Republikës së Kosovës për lirim nga detyra me rastin e pensionimit të një prokurori të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Në pjesën e mbyllur për publikun të takimit të sotëm, KPK-ja ka trajtuar Marrëveshjen Vullnetare të Panelit Hetimor lidhur me rastin AD.nr.05\2022, me ç'rast si e tillë nuk është aprovuar kjo marrëveshje, por anëtarët e Këshillit Prokurorial kanë kërkuar që të kthehet në rishqyrtim.

Diskutohen mundësitë teknike për shkëmbimin elektronik të të dhënave

Në kuadër të diskutimit të mundësive teknike për ndërlidhjen e sistemeve elektronike ndërinstitucionale, Udhëheqësi i Departamentit të Teknologjisë Informative në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është takuar me Udhëheqësin e Sektorit të Hetimeve në Doganat e Kosovës, së bashku me përgjegjësit e sistemeve elektronike të këtij sektori.



Në këtë takim janë fokusuar diskutimet në mundësinë e ndërlidhjes së Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), i cili përdoret në prokuroritë e vendit dhe Sistemit Elektronik (LES) të Doganave të Kosovës, të cilat do të mundësojnë që të dhënat të shkëmbehen

në mënyrë elektronike ndërmjet zyrtarëve doganorë dhe prokurorëve të rastit, duke mundësuar komunikim të shpejtë dhe efikasitet në punë.

Në përmbyllje të këtij takimi, u theksua se synimet e përbashkëta janë që në një të ardhme të afërt të realizohet shkëmbimi elektronik i të dhënave mes të dyja institucioneve.

Shqyrtohen shpenzimet buxhetore të sistemit prokurorial

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës mbahti takimin e radhës, qëllimi i të cilit ishte shqyrtimi i shpenzimeve për të gjitha programet buxhetore të Këshillit dhe për të gjitha kategoritë ekonomike të buxhetit për vitin 2022.



Ushtuesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së prezantoi shpenzimet e të gjitha kategorive ekonomike të buxhetit deri më datën 20 shtator 2022, me ç'rast në fokus të veçantë ishin shpenzimet kapitale.

Komisioni shqyrtoi dhe diskutoi edhe për kërkesa të tjera për personelin administrativ të prokurorive dhe për shpenzime të ekspertizave nga prokuroritë, të cilat janë proceduar për vendim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative, në fokus draftregullorja për Administratën e KPK-së

Komisioni për Çështje Normative i KPK-së shqyrtoi draftin e Rregullores për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në KPK, me ç'rast janë harmonizuar edhe komentet e pranuar nga dëgjimi publik, duke theksuar se sapo të përfundojë së shqyrtuari drafti i Rregullores për Administratën e KPK-së, i njëjti do të dërgohet për miratim në njërin nga takimet e ardhshme të KPK-së.



Monitorohet zbatimi i akteve nënligjore në sistemin prokurorial

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të akteve nënligjore dhe me qëllim të përbushjes së detyrave të punës, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative, vizituan Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe Prokurorinë Themelore në Gjiilan, ku janë pritur nga kryeprokurorët Shukri Jashari dhe Arben Kadriu.

Ndër temat kryesore të diskutimeve ishin aspektet e informimit për zbatimin e akteve nënligjore në fuqi dhe akteve që janë në proces të hartimit, diskutimit dhe miratimit në KPK, lehtësimin e qasjes në to, sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e tyre dhe propozimet eventuale për plotësimin dhe ndryshimin e akteve normative.



Në këtë kontekst është prezantuar edhe Pyetësi i hartuar për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore, i cili do të lehtësojë procesin e punës së Komisionit për Çështje Normative dhe do të ndihmojë në përbushjen e detyrave që ndërliken me mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore dhe hartimin e akteve të parapara me Strategjinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2022-2024.

Komisioni për Çështje Normative, bazuar në Rregulloren e Punës dhe në kuadër të detyrave të

punës së tij, do të zhvillojë edhe vizita të tjera në prokuroritë e vendit.

Mbahet testi kualifikues i kandidatëve për prokurorë të Shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës organizoi mbajtjen e Testit Kualifikues, si hap i ardhshëm i procesit të rekrutimit të njëzetedy (22) prokurorëve në prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës, test ky, i cili është mbajtur në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.



Paraprakisht, për shkak të zbatimit të transparencës së plotë, në prani të vëzhguesve dhe monitoruesve vendorë dhe ndërkombëtarë, ditën e mbajtjes së këtij testi, Komisioni për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit ka hartuar pyetjet për kandidatët që fituan të drejtën për të marrë pjesë në këtë testim.

Në këtë test morën pjesë 333 kandidatë (gjashtë (6) nga komunitet joshumicë), të cilët kanë pasur mundësi që të aplikojnë përmes sistemit online të menaxhimit të dosjeve, përmes dorëzimit të kopjeve fizike, me email dhe postë të rregullt.

Kryesuesi i KPK-së, njëherësh dhe Kryesues i Komisionit, Jetish Maloku, i shoqëruar edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, ka mbikëqyrë rrjedhën e plotë të mbajtjes së Testit Kualifikues.

Në kuadër të monitorimit dhe vëzhgimit të këtij procesi ishin edhe prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë të prokurorive të vendit, prokurorë të deleguar nga Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, prokuroritë themelore dhe përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë nga radhët e EULEX-it, OSBE-së dhe EUKOJUST-it.

Pas mbajtjes së Testit Kualifikues për rekrutimin e prokurorëve të rinj, do të organizohen edhe fazat e tjera të testimit të përgjithshëm sipas standardeve më

të avancuara, të cilat përbëhen nga Testi me Shkrim dhe intervistimi i kandidatëve.

Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës ndaj deklaratës së Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe ndaj veprimeve të OJQ-së Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me anë të një reagimi, ka dënuar ashpër përdorimin sistematik të gjuhës denigruese dhe jo-institucionale të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatesisht Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të përdorur ndaj prokurorëve të shtetit, në emisionin "Rubikon" të Klan Kosovës, ku duke mos zgjedhur mjete, kohë dhe fjalë, po tentohet cenimi i integritetit dhe pavarësisë së Prokurorit të Shtetit, si institucion i pavarur dhe kushtetues.



Këshilli Prokurorial i Kosovës ia rikujton Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës se Prokuroria Themelore në Prishtinë është duke e trajtuar në mënyrë ligjore një kallëzim penal të pranuar nga Agjencia Kundër Korrupsion. Andaj, çfarëdo konspiracioni i ngritur nga ajo lidhur me këtë çështje është i paqëndrueshëm, joprofesional dhe përbënë tentim për njollosjen e sistemit prokurorial.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka potencuar se respekton të drejtën e secilës organizatë të Shoqërisë Civile, në këtë rast, Kolektivit për Mendim dhe Veprim Feminist, për të protestuar lidhur me çfarëdo çështjeje që ka të bëjë me sistemin prokurorial, mirëpo nuk i mirëkupton kur ato devijojnë duke përdorur fjalë fyese dhe denigruese ndaj bartësve të sistemit prokurorial, si dhe duke u munduar kështu të shtyjnë përpara kauza të caktuara politike.

KPK-ja ka theksuar se kjo nuk i shërben aspak aktivizimit të një organizate joqeveritare, por pasqyron në vetvete një veprim publik joracional që është në kundërshtim me parimet dhe të drejtat civile të aktivizimit në shoqëritë demokratike.

Kryesuesi i KPK-së priti në takim Drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i shoqëruar nga Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së, ka pritur në takim Drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK dhe Drejtorin e Departamentit për Luftimin e Korrupsionit në APK.



Qëllimi i takimit ishte njoftimi për aktivitetet dhe sfidat institucionale të ndërsjella dhe diskutimi për modalitetet e zbatimit të kërkesave ligjore që burojnë nga Ligji nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ligj, ky, i cili ka hyrë në fuqi në muajin e kaluar.

Kryesuesi Maloku dhe Drejtori Buleshkaj diskutuan veçanërisht për zbatimin e nenit 18 të këtij ligji, i cili ka të bëjë me obligimet e Prokurorit të Shtetit për ta njoftuar Agjencinë në rastet e referuara për hetimet administrative dhe veprimet e ndërmarra si rezultat i hetimeve.

Bashkëbiseduesit theksuan nevojën e fuqizimit të angazhimit të përbashkët dhe thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit, i cili rrjedhimisht shprehet edhe me anë të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet KPK-së dhe APK-së, të nënshkruar në vitin 2013.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike mbajti takimin e radhës, në të cilin shqyrtoi Raportin e punës për periudhën janar-qershor 2022 dhe diskutoi për aktivitetet e planifikuara gjer në fund të këtij viti kalendarik, në mesin e të cilave ishte edhe zhvillimi i vizitave në prokuroritë e vendit, me qëllim të



monitorimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Telegram ngushëllimi i Kryesuesit të KPK-së drejtuar Ambasadorit të Britanisë së Madhe në Kosovë me rastin e vdekjes së Mbretëreshës Elizabeta II

Prishtinë, 9 shtator 2022

Shkëlqesia Juaj, i nderuari Ambasador i Britanisë së Madhe në Kosovë, z. Nicholas Abbott

Në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta me rastin e kalimit në amshim të Mbretëreshës Elizabeta II, duke u ndjerë thellësisht të pikëlluar nga lajmi për vdekjen e Madhërisë së Saj.

Ne bashkëndejmë dhimbjen me popullin e Mbretërisë së Bashkuar, duke kujtuar kontributin e Mbretëreshës Elizabeta II për të mirën e njerëzimit, virtytet e larta udhëheqëse, të cilat ishin shembulli më i mirë i përkushtimit dhe i angazhimit dinjitoz për të drejtësinë, humanizmin dhe ndikimin pajtues për vlerat e veçanta mbarëbotërore.

Lartmadhëria e Saj u prehtë në paqe!

Me ndjesinë dhe respektin më të thellë!

Sinqerisht i Juaji,

Jetish Maloku,

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Punëtori për prezantimin e komenteve pas dëgjimit publik për dy draftte rregulloresh të sistemit prokurorial

Komisioni për Çështje Normative i KPK-së, i mbështetur nga Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë, EUKOJUST, mbajti një punëtori treditore, në të cilën morën pjesë Kryesuesi i KPK-së, Ushtruesi i

Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kryeprokurorë të prokurorive, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përfaqësues Ambasadës Amerikane dhe përfaqësues të projektit EUKOJUST, anëtarë të Komisionit për Çështje Normative, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së dhe udhëheqës njësisish të administratës së sistemit prokurorial.

Qëllimi i mbajtjes së kësaj punëtorie ishte që anëtarët e KPK-së dhe PSH-së së bashku me përfaqësuesit vendorë dhe ndërkombëtarë të diskutojnë për komentet e pranuar gjatë fazës së dëgjimit publik për draftin e Rregullores për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në KPK dhe draftin e Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorit të Shtetit.



Rrjedhimisht në sesionet e punëtorisë u bë prezantimi i zgjeruar i komenteve për organizimin, funksionimin dhe kushtet e nevojshme për punën e Prokurorit të Shtetit, duke vazhduar me ato për avancimin e veprimtarisë, organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të administratës së sistemit prokurorial.

Në përmbyllje të punëtorisë, u theksua se të gjitha komentet që kanë pasur relevancë do të inkorporohen në draftet finale të këtyre rregulloreve, ndërsa Komisioni për Çështje Normative u pajtua që pas plotësimit të tyre nga ana e administratës të procedohen për miratim në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës ndaj publikimeve linçuese për anëtarin e KPK-së, Prof. Asoc. Dr. Agron Beka

KPK-ja ka reaguar me rastin e publikimeve linçuese për anëtarin e KPK-së, Prof. Asoc. Dr. Agron Beka, në të cilin thuhet:

Anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prof. Asoc. Dr. Agron Beka, i propozuar nga fakultetet juridike dhe i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në detyrën e anëtarit të Këshillit, së fundmi është bërë cak i linçimit publik nga disa eksponentë të caktuar politikë, të cilët po mundohen ta njollosin figurën e tij publike.

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) konsideron se kjo është një fushatë e orkestruar, tendencioze dhe denigruese, e nxitur nga struktura të caktura që kanë për qëllim njollosjen e sistemit prokurorial.



Një fushatë e tillë sistematike është orientuar edhe ndaj këtij anëtari të Këshillit, i cili vije nga radhët e botës akademike dhe që me angazhimin e tij po jep kontribut të vazhdueshëm në avancimin e sistemit prokurorial dhe rrjedhimisht edhe në fuqizimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Raportimi i pasurisë së secilit individ që bartë përgjegjësi apo funksione publike bëhet nëpërmjet deklarimit ligjor dhe janë organet kompetente ato që vlerësojnë ligjshmërinë e saj. Andaj, në këtë rast, anëtari i Këshillit Prokurorial, ka deklaruar se ndaj akterëve të këtyre publikimeve nxitëse do t'i ndjekë të gjitha rrugët ligjore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe anëtarët e tij nuk do të zbrapsen në asnjë moment nga ushtrimi i funksionit dhe mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të atakuar sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi Maloku dhe Dekani Puka nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi ndërmjet KPK-së dhe Fakultetit Juridik të UP-së

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës kanë nënshkruar sot një memorandum të bashkëpunimit.

Qëllimi i memorandumit është krijimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për fuqizimin dhe avancimin e mësimin klinik në UP, me qëllim të përgatitjes së juristëve të rinj për tregun e punës, si dhe ofrimin e ekspertizës



profesionale nga personeli akademik në hartimin e legjislacionit sekondar dhe hartimin e dokumenteve të tjera të rëndësishme për KPK-në.

Konkretisht, përveç bashkëpunimit dhe angazhimeve të tjera me këtë institucion të lartë arsimor, KPK-ja do t'i ofrojë mbështetje Qendrës për Studime Klinike në Fakultetin Juridik, sidomos në ofrimin e lëndëve klinike në fushën penale.

Gjithashtu, memorandumit parasheh që Fakulteti Juridik i UP-së të angazhohet për ofrimin e ndihmës juridike përmes personelit akademik në hartimin e legjislacionit sekondar të nevojshëm për KPK-në dhe akte të tjera sipas nevojës, si dhe do të bashkëpunojë në projekte të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit.

Palët nënshkruese, theksuan gjatë ceremonisë së nënshkrimit se, ky dokument është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të dyja institucionet, sepse përfundimisht krijon mundësinë e bashkëpunimit të avancuar dhe do të shërbejë për ngritjen e cilësisë së punës profesionale në të ardhmen.

Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit ndaj deklaratave të dhëna në një konferencë për media të Kryeministrit dhe Ministres së Drejtësisë

Në një reagim tjetër të KPK-së ndaj deklaratave të dhëna në një konferencë për media të Kryeministrit dhe Ministres së Drejtësisë, thuhet: "Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit shprehin sërish shqetësimin e thellë lidhur riciklimin e vazhdueshëm të deklaratave të pamatura, të paverifikuara ndaj sistemit prokurorial që po bëhen vetëm për konsum dhe agjendë politike nga ana e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Faktikisht, këto prononcime publike të Kryeministrit dhe Ministres së Drejtësisë për parashkrimin e rasteve të dhunës seksuale në Prokurori, demantohen tërësisht nga raportet zyrtare të sistemit prokurorial.

Nga raportet e KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, sipas të dhënave për veprat penale për rastet e dhunës seksuale



përgjatë viteve 2017 deri në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022, janë parashkruar katër (4) raste, që ka pasur të bëjnë me dhunën seksuale.

Në këtë rast, theksojmë se informacionet e deklaruarat sot nga Kryeministri janë të pasakta, nuk kanë të bëjnë asgjë me realitetin dhe janë krejtësisht tendencioze ndaj sistemit prokurorial.

KPK dhe Prokurori i Shtetit ia bëjnë me dije Kryeministrit dhe Qeverisë se statistikatat zyrtare nuk hartohen me paragjykime, por verifikohen, analizohen me profesionalizëm dhe miratohen në takimet e hapura për publikun nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Për më tepër, ky deklaram i pasaktë dhe tendencioz i Kryeministrit, shpreh nevojën që Kryeministri i vendit të bashkëpunojë dhe bashkëveprojë me sistemin prokurorial në suaza të kompetencave përkatëse, duke respektuar normat dhe standardet e funksionimit demokratik të institucioneve në Republikën e Kosovës”.

Reagim i KPK-së dhe KGJK-së

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë reaguar ndaj Kryeministrit të Republikës së Kosovës lidhur me deklaratën e tij në raport me KGJK-në dhe KPK-në për rastin e dhunimit të 11 vjeçares.

Në reagim thuhet: “Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial theksojnë se në raport me këtë çështje sillemi si institucione të përgjegjshme, të pavarura dhe profesionale dhe jo si disa institucione që përmes reagimeve me deklarata publike nuk përngajnë në institucione shtetërore.

Lidhur me këtë rast, ne, si institucione kompetente, në koordinim të plotë me institucionet e tjera relevante, kemi ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme për trajtimin e rastit me profesionalizëm.

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i bëjnë thirrje Qeverisë që të përmbushë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për krijimin e kushteve të nevojshme për strehimin dhe rehabilitimin e viktimave të krimit, në mënyrë që

viktimat e krimit të mos mbesin në mëshirën e organizatave joqeveritare për strehim dhe rehabilitim.

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial sigurojnë opinionin se janë të vendosur për përmbushjen e obligimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me këtë rast dhe të gjitha rastet e tjera pa përjashtim”.

Hartimi i Pyetësorit për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore, në fokus të takimit të Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative ka mbajtur takimin e tij të radhës, me ç’rast diskutoi për përmbushjen e detyrave që ndërlidhen me mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore dhe hartimin e akteve të parapara me Strategjinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2022-2024 dhe, në këtë kontekst, edhe për hartimin e pyetësorit për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre akteve.



Anëtarët e këtij Komisioni u pajtuan për të organizuar edhe vizita informuese nëpër prokuroritë e vendit, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të akteve nënligjore dhe shqyrtuan draftin e Rregulloreve për Angazhimin e Praktikantëve në Sistemin Prokurorial, e cila parasheh procedurat e angazhimit të praktikantëve.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit shtator, zhvilloi konsulta me UNDP-në për procesin e dizajnit dhe zhvillimit të uebfaqes së re të sistemit prokurorial, si dhe ka hartuar të dhënat për dokumentin punues të zbatimit të Planit të Veprimit (2022-2024) për periudhën janar-qershor 2022.

Në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit është implementuar ndërlidhja e re e shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes të regjistratit civil dhe SMIL-it, duke ndikuar në ngritjen e sigurisë gjatë bartjes së të dhënave dhe në bashkëpunim me stafin e KGJK-së ka filluar faza e tretë e avancimit të

shkëmbimit elektronik të të dhënave mes prokurorisë dhe gjykatës.

Gjithashtu është mbajtur një punëtori e organizuar nga Ministria e Drejtësisë për hartimin dhe finalizimin e Konceptdokumentit për nëpunësit civilë në gjykata dhe prokurori dhe një punëtori për shqyrtimin, diskutimin dhe prezantimin e draftit të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorit të Shtetit si dhe Rregullores për Administratën e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ndërkohë është përgatitur edhe Raporti për zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave.

Nga ana tjetër, në kuadër të implemtimit të shkëmbimit të të dhënave, është mbajtur një takim me përfaqësuesit e Doganave, ku janë diskutuar mundësitë teknike për shkëmbimin elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë (SMIL) dhe Doganës.

Po ashtu janë draftuar pyetësorët për monitorimin e zbatimit të akteve nënligjore dhe kontrollit të brendshëm.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHPP-ja, gjatë muajit shtator, hartoi Raportin analitik për ngarkesën dhe efikasitetin e prokurorisë për periudhën e gjashtëmuajorit të parë 2022 krahasuar me gjashtëmuajorin e parë 2021, pastaj hartoi edhe Raportin analitik për lëndët që raportohen lidhur me proceset e integritetit evropiane.

Gjithashtu grumbulloi të dhëna për gjendjen numerike të rasteve për muajin gusht për prokuroritë themelore, Prokurorinë Speciale, atë të Apelit, sipas regjistrave dhe të dhëna për raportet për ngarkesën e prokurorisë me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre.

NJSHPP-ja gjeneroi të dhënat nga aplikacioni KriMKorr për raportet statistikore për gjendjen numerike të rasteve sipas grupeve të veprave penale nga Mekanizmi Përcjellës, sidomos të dhënat statistikore për veprat penale që kanë të bëjnë me armët, përmes të cilave janë grumbulluar të dhëna sipas kërkesës së Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e këtyre veprave penale dhe të dhëna për veprat penale të motivuara nga urrejtja dhe mosdurimi racor, fetar etj, si dhe realizoi vizita monitoruese të implementimit të SML-it në Prokurorinë Themelore të Gjakovës dhe atë Prizrenit, me fokus te cilësia e

shënimeve statistikore të gjeneruara përmes Modulit të Statistikave të SML-it.